



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2024 – Numri: 186

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E premte, 1 nëntor 2024

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 669, datë 30.10.2024	Për një ndryshim në vendimin nr. 639, datë 6.11.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Evropian, në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar..... 20783
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 670, datë 30.10.2024	Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Brendshme tek Agjencia e Zhvillimit të Territorit, të pasurisë nr. 2/371, zona kadastrale 8280, Tiranë, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 250, datë 24.4.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Brendshme”, të ndryshuar..... 20784
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 671, datë 30.10.2024	Për miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, me vendndodhje në digën e Zadejës, HEC “Vau i Dejës”, qarku Shkodër, nga Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) sh.a..... 20788
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 674, datë 30.10.2024	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 19, datë 17.1.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Rehabilitimi i linjës hekurudhore Durrës–Terminali i Transportit Publik Tiranë (PPT) dhe lidhja me Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës (TIA)’”..... 20790
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 675, datë 30.10.2024	Për disa ndryshime në vendimin nr. 749, datë 1.12.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti ‘Ndërtimi i nënstacionit 400 kV Elbasan 3’”..... 20793
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 676, datë 30.10.2024	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit “Zgjerimi i varrezave të qytetit Fushë-Krujë”..... 20795

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 677, datë 30.10.2024	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksioni i rrugëve ‘Faik Pajuni’ dhe ‘Alush Lleshanaku’, në zonën kadastrale 8521, Bashkia Elbasan”.....	20796
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 678, datë 30.10.2024	Për përbërjen, rregullat më të hollësishme të organizimit dhe funksionimit të këshillave vendorë të sigurisë publike dhe Këshillit Kombëtar për Sigurinë në Komunitet.....	20799
Udhëzim i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 27, datë 23.10.2024	Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 21, datë 25.11.2010, “Mbi kërkesat specifike të higjienës dhe kontrollet zyrtare për produktet me origjinë shtazore”, të ndryshuar.....	20802
Urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 542, datë 25.10.2024	Për delegim kompetence.....	20811



VENDIM

Nr. 669, datë 30.10.2024

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 639, DATË 6.11.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË ORGANIKËS SË AGJENCISË SË AUDITIMIT TË PROGRAMEVE TË ASISTENCËS, AKREDITUAR NGA BASHKIMI EVROPIAN, NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 21, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, dhe të pikës 4, të nenit 6, të ligjit nr. 90/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Evropian, në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 2, të vendimit nr. 639, datë 6.11.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Evropian, në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, organika e Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Evropian, zëvendësohet me organikën sipas skemës 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Agjencia e Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Evropian, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

Skema 2

ORGANIKA E AGJENCISË SË AUDITIMIT TË PROGRAMEVE TË ASISTENCËS, AKREDITUAR NGA BASHKIMI EVROPIAN

NR	POZICIONI	KATEGORIA	NUMRI
I.	Drejtor i Përgjithshëm	I-3	1
II.	Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm	II-1	1
III.	Drejtorja e Auditimit të Programeve IPA		7
	Drejtor	II-1	1
	Auditues i Parë	II-1	3
	Auditues i Dytë	III-1	3
IV.	Drejtorja e Auditimit të Programeve IPARD		7
	Drejtor	II-1	1
	Auditues i Parë	II-1	4
	Auditues i Dytë	III-1	2
V.	Drejtorja e Financës dhe Juridike		7
	Drejtor	II-2	1
	Sektori i Financës dhe Administratës		3
	Përgjegjës Sektori	III-2	1
	Specialist (Buxhet/Financë)	IV-2	1
	Specialist (Buxhet Njerëzore/ Arkiv Protokolli)	IV-2	1
	Sektori Juridik dhe Marrëdhëniet me Jashtë		3
	Përgjegjës Sektori	III-2	1
	Specialist (Juri)	IV-2	1
	Specialist (Marrëdhëniet me Jashtë)	IV-2	1
	Punonjës gjithsej		23

**VENDIM****Nr. 670, datë 30.10.2024**

**PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË
ADMINISTRIMIT, NGA MINISTRIA E
BRENDSHME TEK AGJENCIA E
ZHVILLIMIT TË TERRITORIT, TË
PASURISË NR. 2/371, ZONA
KADASTRALE 8280, TIRANË, DHE PËR
NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 250,
DATË 24.4.2003, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E
LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE
TË PALUAJTSHME SHETËTËRORE, TË
CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI MINISTRISË SË
BRENDSHME”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Brendshme tek Agjencia e Zhvillimit

të Territorit, të pasurisë nr. 2/371, zona kadastrale 8280, me sipërfaqe truall 6 358,98 (gjashtë mijë e treqind e pesëdhjetë e tetë presje nëntëdhjetë e tetë) m² dhe sipërfaqe ndërtese 1 290,80 (një mijë e dyqind e nëntëdhjetë presje tetëdhjetë) m², sipas kartelës së pasurisë së paluajtshme dhe fragmentit të hartës kadastrale, që i bashkëlidhen këtij vendimi, për ushtrimin e funksioneve administrative.

2. Agjencisë së Zhvillimit të Territorit i ndalohej të ndryshojë destinacionin e përdorimit të pasurisë së përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

3. Prona e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme, bashkëlidhur vendimit nr. 250, datë 24.4.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Brendshme”, të ndryshuar.

4. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

Kodi Unik 8280003084
(Nga 8280003032, Në ____)

A - TË DHËNAT E PASURISË

Zona Kadastrale Nr. 8280, Lloji i Pasurisë: TRUALL, Nr. i Pasurisë: 2/371, Sipërfaqja Totale 6358.98m²,
(Nga të Cilat Truall 6358.98m²; Ndërtesë 1290.8m²)

Indeksi i Hartës Kadastrale TR-V-13.14, Numri i Pemëve: 0,
Adresa e Pasurisë: Bashkia TIRANË, Rruga _____, Ndërtesa Nr. _____, SH/K _____, Apartamenti Nr. _____
Vlera e Pasurisë:
Fillestare _____ (Akti Nr. _____, Dt. _____), Rivlerësim _____ (Akti Nr. _____, Dt. _____)

B – TË DHËNAT E TITULLIT TË PRONËSISË

Pronari: REPUBLIKA E SHQIPËRISË - , Nr. Identifikimi/NIPT SG6445855081, Pjesa Takuese 1/1,
Lloji i Pronësisë: I
Adresa e Pronarit: Bashkia TIRANE, Rruga _____, Ndërtesa Nr. _____, SH/K _____, Apartamenti Nr. _____
Akti i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: _____, Nr. _____, Datë: _____
Regjistruar: Nr. 00000704, Datë: 08/11/2019

**Pjesëmarrës në Bashkëpronësi të Detyrueshme për Pasurinë Nr. _____, me Kod Unik _____*

B/1 – TË DHËNAT E REGJISTRIMIT PARAPRAK

Akti Paraprak i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: _____, Nr. _____, Datë: _____
Përshkrimi i Objektit të Aktit: _____
Regjistruar: Nr. _____, Datë: _____

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

C-TË DREJTAT REALE

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i të Drejtës	Të Dhënat e Aktit			Afat i Vlefshmërisë	Përfitues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/ NIPT
00000704	08/11/2019		NE PERGJEGJISI ADMINISTRIMI MINISTRISË SE RENDIT PUBLIK (GARDA E REPUBLIKES NJESIA SPECIALE) VKM			0		

D - KUFIZIMET E PRONËSISË

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i Kufizimit	Të Dhënat e Aktit			Afat i Kufizimit	Përfitues/Kërkues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/ NIPT

E - INFORMACIONE TË TJERA PËR PRONËN

Lloji i Informacionit: _____, Emërtimi i Aktit: _____, Nr. _____, Datë: _____

Regjistruar: Nr. _____, Datë: _____


Përshkrimi: SIP E NDERT 1367.40 S1=1290.80M2 S2=76.60M2DREJTORI
Filadi DanoEvdhoksi
aDigitally signed by:
Evdhoksia Xoxi
Date: 2024.10.25
02:16:03 +02'00'Thoma
RizaDigitally signed by:
Thoma Riza
Date: 2024.10.25
02:28:05 +02'00'Filadi
DanoDigitally signed by:
Filadi Dano
Date: 2024.10.25
02:33:01 +02'00'Vulosur elektronikisht nga Drejtoria
Vendore Tiranë Jug
Date: 2024/10/25 14:15:14 +02'00"
L52205454A2024102514150766ASHKShënim: Ky dokument është generuar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Agjencia Shtetërore e Kadastrës)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

FRAGMENT I HARTËS KADASTRALE

ZONA KADASTRALE: 8280KODI UNIK: 8280003084NUMRI PASURISË: 2/371INDEKSI HARTËS: TR-V-13.14

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE



SH 1: 1000

DREJTORI

Flladi Dano

Thoma
RizaDigitally signed by:
Thoma Riza
Date: 2024.10.25
10:25:00 +02'00'Flladi
DanoDigitally signed by:
Flladi Dano
Date: 2024.10.25
10:25:00 +02'00'Vulosur elektronikisht nga Drejtoria
Vendore Tiranë Jug
Date: 2024/10/25 14:28:39 +02'00'
L52205454A202410251428328614014Shënim: Ky dokument është gëneruar dhe vuloar me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Agjencia Shtetërore e Kadashtës)

SHPJEGUES

- PARCELA
- NDËRTESA



VENDIM

Nr. 671, datë 30.10.2024

**PËR MIRATIMIN E NDËRTIMIT TË
CENTRALIT GJENERUES TË
ENERGJISË ELEKTRIKE
FOTOVOLTAIKE DHE VEPRAVE
NDIHMËSE, I CILI NUK ËSHTË
OBJEKT KONCESIONI, ME
VENDNDODHJE NË DIGËN E
ZADEJËS, HEC “VAU I DEJËS”, QARKU
SHKODËR, NGA KORPORATA
ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE
(KESH) SHA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të pikës 1, të nenit 49, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe në vijim të pikës 2, të nenit 21, të vendimit nr. 822, datë 7.10.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni dhe nuk përfiton nga masat mbështetëse, në digën e Zadejës, Hec “Vau i Dejës”, qarku Shkodër, nga Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) sh.a., me elementet, si më poshtë vijon:

a) Emri i aplikuesit: Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) sh.a.;

b) NIPT/NUIS: J61817005F;

c) Tipi i centralit: fotovoltaike;

ç) Kapaciteti i instaluar: 8.25 mw;

d) Afati i pritshëm i vënies në punë dhe pajisja me leje ndërtimi: Koha për ndërtimin, pajisjen me lejen e ndërtimit dhe vënien në operim të impiantit fotovoltaike do të jetë brenda 36 (tridhjetë e gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;

dh) Vendndodhja e burimit gjenerues të energjisë: Në digën e Zadejës, HEC “Vau i Dejës”, qarku Shkodër;

e) Afati i operimit: 49 (dyzet e nëntë) vjet nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;

ë) Koordinatat e tokës dhe planvendosja, sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

f) Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore kanë të drejtë të ushtrojnë mbikëqyrje të përgjithshme me afate 3-mujore gjatë realizimit, vënies në punë dhe operimit, me synim që të verifikojnë se ecuria e punimeve, cilësia, konformiteti dhe operimi janë në përputhje me programin e përgjithshëm të realizimit dhe të dokumentacionit të projektit;

g) E drejta për ndërtimin e burimit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni dhe nuk përfiton nga masat mbështetëse, në digën e Zadejës, HEC “Vau i Dejës”, qarku Shkodër, e dhënë sipas këtyre rregullave, mund të transferohet te një subjekt i tretë, vetëm me miratimin e Këshillit të Ministrave;

gj) Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) sh.a., ka detyrimin që:

i. të paraqesë periodikisht (çdo tre muaj) pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore informacion për ecurinë e ndërtimit të centralit fotovoltaike;

ii. të respektojë kushtet e cituara në lejet, licencat dhe autorizimet paraprake mjedisore, lëshuar nga institucionet përgjegjëse kombëtare;

iii. të dorëzojë sigurimin e kontratës, në masën jo më pak se 5% të vlerës së investimit, përpara nënshkrimit të kontratës, ndërmjet shoqërisë (KESH) sh.a. dhe ministrisë. Në këtë kontratë përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve për realizimin e këtij projekti, penalitetet, në rast mosrealizimi, si dhe çështje të tjera që lidhen me zbatimin e saj;


iv. t'i japë falas, në formë *royalty*, ministrisë përgjegjëse për energjinë sasinë e energjisë elektrike, në masën 2 % të sasisë vjetore të prodhimit të energjisë elektrike ose konvertimin e saj në vlerë monetare. Në rast konvertimi në vlerë monetare, shuma duhet të derdhet tërësisht në buxhetin e shtetit;

v. të përmbushë kërkesën, sipas rastit, që një pjesë e prodhimit të burimit gjenerues të energjisë t'i shitet furnizuesit publik, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore dhe Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

KOORDINATAT E CENTRALIT ELEKTRIK FOTOVOLTAIK NË DIGËN E ZADEJËS, HEC “VAU I DEJËS”, QARKU SHKODËR, NGA KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE (KESH) sh.a.				
Koordinatat KRGJSH	Pika 1	Pika 2	Pika 3	Pika 4
x	468901.86	469203.56	469088.76	468889.96
y	4653927.44	4653724.44	4653625.74	4653753.84



**VENDIM****Nr. 674, datë 30.10.2024**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR. 19, DATË 17.1.2024, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT ‘REHABILITIMI I LINJËS
HEKURUDHORE DURRËS–TERMINALI
I TRANSPORTIT PUBLIK TIRANË (PPT)
DHE LIDHJA ME AEROPORTIN
NDËRKOMBËTAR TË TIRANËS (TIA)”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 19, datë 17.1.2024, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “arë” dhe “trull”, me vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 280 445 392.25 (dyqind e tetëdhjetë milionë e katërqind e dyzet e pesë mijë e treqind e nëntëdhjetë e dy pikë njëzet e pesë) lekësh.”.

2. Në pikën 4, fjalët “... prej 104 085 941.87 (njëqind e katër milionë e tetëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e dyzet e një pikë tetëdhjetë e shtatë) lekësh” zëvendësohet me “... prej 280 445 392.25 (dyqind e tetëdhjetë milionë e katërqind e dyzet e pesë mijë e treqind e nëntëdhjetë e dy pikë njëzet e pesë) lekësh.”.

3. Në tabelën bashkëlidhur vendimit bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Vlerat e shpronësimit të pasurive të paraqitura në nënndarjet me numrat rendorë 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 15, 16, 18, 20, 21, 22, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35 dhe 36 zëvendësohen me vlerën e shpronësimit në nënndarjet përkatëse, sipas tabelës ndryshuese, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

b) Pas nënndarjes me numër rendor 43 shtohen pasuritë që shpronësohen, të paraqitura me nënndarjet me numër rendor nga 44–84, sipas tabelës shtesë që i bashkëlidhet këtij vendimi.

II. Shpenzimet procedurale shtesë, në vlerën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga shoqëria “Hekurudha Shqiptare” sh.a.

III. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, shoqëria “Hekurudha Shqiptare” sh.a., drejtoritë vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kamzë Vorë, Tiranë Rurale 2 dhe Krujë, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Tiranë, si dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku**



66	ZAKA	SHUMAL	DORUSHI	BERXULLI	1167	32/8	ARE	520	520			2	97	2160.0	2114.82	4,560,111.20							9.5	20,120.00				4,580,231.20																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																								
68	KATRI	ASLAN	SEJA	BERXULLI	1167	29/5	ARE	1020	1020			1	199	3252.0	2114.82	6,855,096.24							9.5	96,704.00				6,865,066.24																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																								
69	SEJDI	HAMIR	ISHADJ	BERXULLI	1167	29/9	ARE	1020	1020			1	206	440.0	2114.82	950,120.00							9.5	4,180.00				954,300.00																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																								
71	HAMIR	KUMRUP	NERDAL	BERXULLI	1167	29/14	ARE	650	650			13	24	1440.0	2114.82	1,069,324.00							8.0	12,604.00				1,081,928.00																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																								
72	GANI	KUMRUP	NERDAL	BERXULLI	1167	29/10	ARE	650	650			13	22	820.0	2114.82	1,733,185.76							8.5	7,046.50				1,740,232.26																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																								
73	MYSEJDI	BEJSE	KUCQI	KAMEZ	1649	3/9	ARE	1440	1440			33	35	1604.0	2114.82	3,922,171.20									62,680.00			3,984,851.20																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																								
74	KAMEZ	MUSA	SADRIKU	KAMEZ	2066	2/13	ARE	480	480			9	132	294.0	2114.82	6,980,020.00												6,986,996.00																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																								
75	FADIL	MUSA	SADRIKU	KAMEZ	2066	2/14	ARE	520	520			3	133	377.0	2114.82	1,220,251.14												1,220,251.14																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																								
76	VARF MYSEJDI FADIL RAMES MINUSHI AFRIM SEJA	MUHAREM MUSA MUSA IBRAHIM	SADRIKU SADRIKU SADRIKU SADRIKU SADRIKU	KAMEZ	2066	2/15	ARE	4800	4800			3	134	126.0	2114.82	266,467.32							9.5	1,197.00				267,664.32																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																								
77	ALKEJTA IRUNA DORINA DYLAVER HYREH DRIJAN	DYLAVER PANI KRASNQI KALLARI KALLARI KALLARI	KUTLLAJ PANI KRASNQI KALLARI KALLARI KALLARI	QUREKE	3096	23/14	ARE	6525	6525			11	192	1320	5287.05	6,978,906.00												6,978,906.00																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																								
78	LAMI HAMIR	HAMIR HALIT	RIJAK KALLARI	QUREKE	3096	23/15	ARE	430	430			11	191	84	5287.05	444,112.20												444,112.20																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																								
79	DYLAVER HYREH JORANDA ALKEJTA IRUNA DRIJAN	HAMIR HAMIR DYLAVER DYLAVER DYLAVER DYLAVER	KALLARI KALLARI KALLARI KUTLLAJ PANI KALLARI	QUREKE	3096	23/12	ARE	225	225			11	190	71	5287.05	373,380.55												373,380.55																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																								
80	KUTLLAJ	SEJA	SEJA	QUREKE	3096	23/10	ARE	360	360			2	193	725	5287.05	3,833,111.25												3,833,111.25																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																								
81	Varf shari - Podonues NDERIM IKRAF			KASHAR	2119	543/1	TRUALLI					14	182												922,082.40			922,082.40																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																								
82	Varf shari - podonues SUKRI ZIRI			KASHAR	2119	543/1	TRUALLI					14	182													422,036.10			422,036.10																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																							
83	SHQËRRIA "ELKOR"			MEZIZ	2079	66/72	TRUALLI	4157		4157		35	136			4157	7049.40	20,104,333.80									20,304,333.80																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																									
84	SHQËRRIA "ELKOR"			MEZIZ	2079	66/73	TRUALLI	17290		17290		35	131			17,014,095.42	5400	7049.40	12,211,030.00									12,211,030.00																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																								
Vitet totale																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																																				</

**VENDIM****Nr. 675, datë 30.10.2024**

**PËR DISA NDRYSHIME NË
VENDIMIN NR. 749, DATË 1.12.2022, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA PROJEKTI ‘NDËRTIMI
I NËNSTACIONIT 400 kV ELBASAN 3’”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 749, datë 1.12.2022, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) në pikat 3 dhe 4, vlera “... prej 13 475 622 (trembëdhjetë milionë e katërqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e njëzet e dy) lekësh” zëvendësohet me “... 40 758 621 (dyzet milionë e

shtatëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e njëzet e një) lekë”;

b) tabela, bashkëlidhur vendimit, zëvendësohet me tabelën me të njëjtin emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Pronarët e pasurive me numrat 44/3/2, 44/4, 45/7, 45/12, 45/1/3, 45/1/4, që janë likuiduar sipas vlerës së përcaktuar para hyrjes në fuqi të këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, vetëm për diferencën e vlerës së shtuar të kompensimit, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Shpenzimet procedurale shtesë, në vlerën 90 000 (nëntëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a.

4. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Operatori i Sistemit të Transmetimit, sh.a., Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Elbasan, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Elbasan për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku**



LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI “NDËRTIMI I NËNSTACIONIT 400 kV ELBASAN 3”

Nr. rendor	Pronësia			Të dhënat kadastrale (sipas kartelës së pasurisë)				Sip. që shpronësohet (m²)	Çmimi i tokës (lekë/m²) llogaritur sipas raportvlerësimit të përgatitur nga ekspertët vlerësues	Vlera e kompensimit për tokën (lekë)	Kompensimi sipas standardit ndërkombëtar (vlera në lekë)										Vlera totale e kompensimit sipas standardit ndërkombëtar (lekë)	Shënime	
	Emri	Atësia	Mbiemri	ZK	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. e pronës (m²)				Kultura vjetore (m²)		Kulturat shumëvjeçare (nr. pemësh)										
											Jonxhë	Misër	Ullinj 2-6 vite	Ullinj 11-20 vite	Ullinj 21-30 vite	Portokall 2-4 vite	Shegë >5 vite	Arrë 5-10 vite	Arrë 11-30 vite	Shuma e kompensimit për të mbjellat (lekë)			
Bashkia Elbasan																							
Fshati Kryezjarrth																							
1	Feim Avdul Zeneli & Alië Begdash Zeneli			2296	44/1/3	Arë	2,500	2500	589	1,472,500	2,500										6,143	1,478,643	
2	Mirela Preni		Merdani	2296	44/1/4	Arë	2,000	2000	589	1,178,000				42			9		4		1,202,470	2,380,470	
3	Nosi Vasil		Biba	2296	44/2	Arë	4,000	4000	589	2,356,000		4,000									41,200	2,397,200	
4	Eglantina Josif		Ranxha	2296	44/3/1	Arë	1,625	1625	589	957,125												957,125	
5	Kozeta Josif		Kuçi	2296	44/3/2	Arë	1,625	1625	589	957,125												957,125	
6	Ndriçim Marthe		Tollumi	2296	44/4	Arë	3,792	3792	589	2,233,488												2,233,488	
7	File Feride Ervin Mirjan Aferdita Dhimiter Vangjeli Jani	Tasi Dylber Jani Vasil Vasil Vasil	Zela Zela Zela Zela Sollaku Zela Xhija Zela	2296	44/5	Arë	2,831	2831	589	1,667,459		2,700									29,159	1,696,618	
8	Dhimiter Bukuri Kujtim Dashamir	Vasil Venemini Dhimiter	Zela Zela Zela Zela	2296	44/6	Arë	2,700	2700	589	1,590,300												1,590,300	
9	Thoma Ili		Bica	2296	45/2/1	Arë	2,900	2900	589	1,708,100	2,900										7,125	1,715,225	
10	Jorgji Tasi		Bica	2296	45/3	Arë	2,750	2750	589	1,619,750					110						3,116,011	4,735,761	
11	Foti		Ranxha	2296	45/4	Arë	3,200	3200	589	1,884,800	3,200										7,863	1,892,663	
12	Thoma Aferdita Gentian Alfred Eduard Ervin	Spiro Grigor Thoma Thoma Thoma	Roçi Roçi Roçi Roçi Roçi	2296	45/7	Arë	3,539	3539	589	2,084,471												2,084,471	
13	Kostandin Simon		Drizari	2296	45/8	Arë	5000	5000	589	2,945,000	2,500	2,500							1		46,818	2,991,818	
14	Petrit Grigor		Drizan	2296	45/9	Arë	2,500	2500	589	1,472,500	2,500										6,143	1,478,643	
15	Igor Simon		Drizari	2296	45/10	Arë	810	810	589	477,090	440										1,081	478,171	
16	Agim Jakov		Tollumi	2296	45/11	Arë	2,715	2715	589	1,599,135			125								1,259,026	2,858,161	
17	Nikolla Vasil		Biba	2296	45/12	Arë	1,570	1570	589	924,730												924,730	
18	BP Aleks Vasil Biba			2296	45/13	Arë	4,590	4590	589	2,703,510		4,590									47,277	2,750,787	
19	Bashkim Vasil		Biba	2296	45/14	Arë	2,375	2375	589	1,398,875												1,398,875	
20	Gezim Naut Shati & Bakurie Petër Shati			2296	45/15	Arë	1,625	1625	589	957,125	1,625		31								316,231	1,273,356	
21	Eduard Jorgji		Oga	2296	45/1/3	Arë	2,000	2000	589	1,178,000												1,178,000	
22	Eduard Jorgji		Oga	2296	45/1/4	Arë	2,219	2219	589	1,306,991												1,306,991	
Nënstacioni 400 kV, Elbasan 3 - shuma e kompensimit (lekë)										34,672,074											6,086,547	40,758,621	

**VENDIM****Nr. 676, datë 30.10.2024****PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “ZGJERIMI I VARREZAVE TË QYTETIT FUSHË-KRUJË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit “Zgjerimi i varrezave të qytetit Fushë-Krujë”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Krujë.

3. Pronarët e pasurisë së paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasurinë e llojit “arë”, me një vlerë të përgjithshme prej 624 512 (gjashtëqind e njëzet e katër mijë e pesëqind e dymbëdhjetë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 624 512 (gjashtëqind e njëzet e katër mijë e pesëqind e dymbëdhjetë) lekësh, përballohet nga buxheti i Bashkisë Krujë.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga buxheti i Bashkisë Krujë.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i

përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurisë së paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Krujë.

8. Bashkia Krujë kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Krujë.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Krujë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Krujë për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Krujë për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Krujë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Krujë, Drejtoria e Administrimit dhe e Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Durrës dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku



Lista emërore përfundimtare e pronarëve, pasuri e paluajtshme, pronë private, që shpronësohen për interes publik, nga realizimi i projektit “Zgjerimi i varrezave të qytetit Fushë-Krujë”

Nr.	Pronari			Të dhënat kadastrale (sipas kartelës së pasurisë)							Vlerësimi për shpronësim				
											"Arë"			Vlera totale në (lekë)	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri	Fshati ose Qyteti	Zona Kadastrale	Numri i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja Totale	Volumi	Faqe	Sipërfaqja (m2)	Çmimi (lekë/m2)	Vlera (lekë)		
1	Shpetim	Shaban	Babaj	Fshat Fushë-Krujë, Krujë	1665	247/3	Arë	2000	4	16	2000	287	574000	574000	Konfirmuar nga ASHK
2	Saba	Haxhi	Tali	Fshat Fushë-Krujë, Krujë	1665	246/6	Arë	4600	5	56	3	287	861	861	Konfirmuar nga ASHK
3	Saba	Haxhi	Tali	Fshat Fushë-Krujë, Krujë	1665	246/7	Arë	4000	5	54	173	287	49651	49651	Konfirmuar nga ASHK
Vlera Totale													624,512		
Çmimet janë marrë nga harta e vlerës, miratuar me VKM NR.89, DT.3.2.2016															

VENDIM

Nr. 677, datë 30.10.2024

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “RIKONSTRUKSIONI I RRUGËVE ‘FAIK PAJUNI’ DHE ‘ALUSH LLESHANAKU’, NË ZONËN KADASTRALE 8521, BASHKIA ELBASAN”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturs dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksioni i rrugëve ‘Faik Pajuni’ dhe ‘Alush Lleshanaku’, në zonën kadastrale 8521, Bashkia Elbasan”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Elbasan.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “truall”, me një vlerë të përgjithshme prej 1 698 683.8 (një milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e tre pikë tetë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 1 698 683.8 (një milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e tre pikë tetë) lekësh, përballohet nga buxheti i Bashkisë Elbasan.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga buxheti i Bashkisë Elbasan.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Elbasan.

8. Bashkia Elbasan kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Elbasan.



10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Elbasan, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Elbasan për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të

Bashkisë Elbasan për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Elbasan, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Elbasan, dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Belinda Balluku



LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE TË TË CILËVE SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK PËR REALIZIMIN E PROJEKTTIT “RIKONSTRUKSION I RRUGËVE ‘FAIK PAJUNI’ DHE ‘ALUSH LLESHANAKU’ NË ZK 8521, BASHKIA ELBASAN”

NR.	Pronari			Të dhënat kadastrale (sipas kartelës së pasurisë)										Vlerësimi për shpronësim							Shënime (d+e) (kufizime hipotekore, barrë mbi pasurinë etj.)
														“Trrall”			“Ndërtesë”			Vlera totale (lekë)	
	Emri	Atësia	Mbiemri	Fshati ose qyteti	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	“Arë” (m²)	“Trrall” (m²)	“Ndërtesë” (m²)	Volumi	Faqe	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)		
1	Beqir Nektar Sopot Dhurata Dashamira	Bukurosh Bukurosh Bukurosh Bukurosh Bukurosh	Sejdini Sejdini Sejdini Sejdini Sejdini	Elbasan	8521	3/486	Trrall	150	0	150	0	0	0	84.3	13,666	1,152,043.8	0	0	0	1,152,043.8	Konfirmuar nga ASHK-ja
2	Besnik	Shazivar	Muzhaqi	Elbasan	8521	3/225	Trrall	40	0	40	0	0	0	40	13,666	546,640	0	0	0	546,640	Konfirmuar nga ASHK-ja
	Vlera totale																			1,698,683.8	



VENDIM

Nr. 678, datë 30.10.2024

**PËR PËRBËRJEN, RREGULLAT MË TË
HOLLËSISHME TË ORGANIZIMIT
DHE FUNKSIONIMIT TË KËSHILLAVE
VENDORË TË SIGURISË PUBLIKE DHE
KËSHILLIT KOMBËTAR PËR
SIGURINË NË KOMUNITET**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 12/1, të ligjit nr. 107/2016, “Për prefektin e qarkut”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e përbërjes dhe të rregullave më të hollësishme të organizimit e të funksionimit të këshillave vendorë të sigurisë publike dhe Këshillit Kombëtar për Sigurinë në Komunitet.

2. Me propozimin e prefektit të qarkut pranë çdo bashkie, si njësi bazë e vetëqeverisjes vendore, ngrihen këshillat vendorë të sigurisë publike, të cilët kryesohen nga kryetarët e bashkive dhe përbëhen nga:

- a) shefi i Komisarariatit të Policisë;
- b) drejtuesi i Policisë Bashkiake;
- c) përfaqësuesi i Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar;
- ç) drejtuesi i emergjencave civile në bashki;
- d) përfaqësuesi i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror;
- dh) përfaqësuesi i Drejtorisë Rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor;
- e) përfaqësuesi i njësisë vendore të kujdesit shëndetësor;
- ë) përfaqësuesi i Agjencisë Rajonale të Mjedisit;
- f) përfaqësuesi i Drejtorisë Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit;
- g) përfaqësuesi i administratës rajonale të zonave të mbrojtura;
- gj) koordinatori vendor për referimin dhe menaxhimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare;
- h) përfaqësuesi i njësisë për mbrojtjen e fëmijëve;
- i) kryeinspektori i Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit;
- j) përfaqësuesi i Agjencisë së Mbrojtjes së Konsumatorit.

3. Këshilli Vendor i Sigurisë Publike funksionon si një organizëm koordinues, identifikues dhe konsultues për problematikat që lidhen me çështjet e rendit dhe sigurisë në komunitet.

4. Kryetari i Këshillit Vendor të Sigurisë Publike mund të ftojë në mbledhjet e tij përfaqësues nga:

- a) Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm;
- b) Prokuroria e Juridiksionit të Përgjithshëm;
- c) komunitetet fetare;
- ç) organizatat e shoqërisë civile (organizatat rinore, të grave, të bizneseve, të pakicave kombëtare, të universiteteve, të mediave lokale), të komunitetit, sipas rastit;
- d) Këshilli Vendor i Rinisë;
- dh) Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit;
- e) shoqatat e njësive të vetëqeverisjes vendore;
- ë) Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut;
- f) shoqatat e mbrojtjes së konsumatorëve.

5. Njoftimi për datën e zhvillimit të mbledhjes dërgohet me shkresë zyrtare, të paktën 5 (pesë) ditë pune përpara datës së përcaktuar, për përfaqësuesit e përmendur në pikën 4, të këtij vendimi.

6. Kryetari i Këshillit Vendor të Sigurisë Publike ushtron përgjegjësitë, si më poshtë vijon:

- a) ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për të siguruar funksionimin efektiv dhe efikas të Këshillit Vendor të Sigurisë Publike;
- b) organizon mbledhjet e Këshillit Vendor të Sigurisë Publike, minimalisht 1 (një) herë në 3 (tre) muaj ose sa herë vlerësohet e nevojshme nga anëtarët e tij;
- c) propozon për vendimmarrje në Këshillin Vendor të Sigurisë Publike detyra dhe masa konkrete, sipas përgjegjësiave institucionale për zbatimin e prioriteteve për çështjet e rendit dhe të sigurisë në komunitet;
- ç) harton, konsulton, miraton, ndjek dhe raporton planin vjetor të punës, sipas masave të planit të veprimit të strategjisë ndërsektoriale të sigurisë në komunitet;
- d) përfaqëson Këshillin Vendor të Sigurisë Publike në marrëdhëniet me të tretët, duke përfshirë bashkëpunimet me organizmat ndërkombëtarë dhe ata vendas;
- dh) fton në mbledhjet e Këshillit Vendor të Sigurisë Publike përfaqësuesit e institucioneve, sipas pikës 4, të këtij vendimi;



e) zhvillon forume të hapura konsultative me qytetarët për identifikimin dhe evidentimin e problematikave, lidhur me sigurinë në komunitet.

7. Këshilli Vendor i Sigurisë Publike ushtron këto detyra dhe përgjegjësi:

a) angazhohet për parandalimin, minimizimin e rreziqeve dhe kërcënimeve në çështjet që cenojnë sigurinë në komunitet;

b) mbikëqyr dhe zbaton planin vjetor të punës, sipas masave të planit të veprimit të strategjisë ndërsektoriale të sigurisë në komunitet;

c) identifikon, analizon dhe vlerëson problematikat lidhur me sigurinë në komunitet dhe i trajton ato në mbledhjet e këshillit;

ç) propozon zgjidhje për problematikat e rasteve konkrete tek autoritetet kompetente shtetërore, pjesëmarrëse ose jo në Këshillin Vendor të Sigurisë Publike;

d) identifikon prioritetet në fushën e sigurisë në komunitet dhe rekomandon përfshirjen e tyre në mbledhjen e radhës;

dh) propozon dhe vlerëson detajet e veprimtarisë së institucioneve përgjegjësie për sigurinë publike në komunitet dhe ia komunikon ato drejtuesve të tyre;

e) kontribuon dhe siguron pjesëmarrje në aktivitete ndërgjegjësuere për komunitetin edhe përmes projekteve për çështjet e sigurisë në komunitet;

ë) vendos me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të tij;

f) merr në shqyrtim përmbushjen e rekomandimeve për çështjet e trajtuara në Këshillin Vendor të Sigurisë Publike;

g) përcakton përbërjen e sekretariatit teknik.

8. Sekretariati teknik ushtron këto detyra:

a) përgjigjet për mbarëvajtjen e veprimtarisë së këshillit vendor nga ana logjistike dhe administrative;

b) mban, ruan dhe përditëson të gjitha kontaktet e anëtarëve të këshillit;

c) organizon dhe bën koordinimin e mbledhjeve të këshillit;

ç) njofton anëtarët për mbledhjen e radhës;

d) përgatit materialet përkatëse paraprake të mbledhjes, sipas rendit të ditës për anëtarët;

dh) merr pjesë në mbledhjet e këshillit, duke mbajtur minutat e takimit;

e) shkëmben informacionin dhe materialet e mbledhjes midis anëtarëve;

ë) harton procesverbalet e mbledhjes dhe raportet;

f) Mban listën e pjesëmarrësve të pranishëm në mbledhje;

g) protokollon dhe mban arkivin e procesverbaleve të mbledhjeve;

gj) kontrollon adresën elektronike, si mjet të komunikimit elektronik të këshillit;

h) përgatit dhe bën publikimin e njoftimeve apo materialeve të ndryshme për publikun.

9. Këshilli Vendor i Sigurisë Publike zhvillon mbledhjet, në bazë të rendit të ditës, të miratuar nga kryetari dhe anëtarët, sipas procedurës së mëposhtme:

a) njoftimi për datën e zhvillimit të mbledhjes dërgohet të paktën 5 (pesë) ditë pune përpara datës së përcaktuar, me shkresë zyrtare ose në formë elektronike, për të cilën anëtarët kanë rënë dakord;

b) anëtarët njoftohen paraprakisht edhe për rendin e ditës dhe për çdo informacion tjetër të nevojshëm;

c) në përcaktimin e çështjeve të rendit të ditës mund të kontribuojnë edhe anëtarët;

ç) propozime për rendin e ditës mund të dërgohen edhe përmes adresës elektronike nga çdo qytetar;

d) mbledhjet mbahen kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të përhershëm të këshillit. Në rastet kur ky numër nuk plotësohet, mbledhja shtyhet në një datë tjetër, por jo më vonë se 3 (tri) ditë pune;

dh) në mbledhjet me anëtarësi më të vogël pjesëmarrësish mund të diskutohen çështje, por nuk mund të merren vendime pa kuorumin e nevojshëm;

e) mbledhja hapet dhe drejtohet nga kryetari, i cili bën edhe prezantimin e rendit të ditës, si dhe një përmbledhje të zhvillimeve të fundit të punës së këshillit;

ë) kryetari drejton diskutimin, përcakton fillimin dhe përfundimin e shqyrtimit të secilës çështje të rendit të ditës;

f) anëtarët diskutojnë në bazë të rendit të ditës dhe raportojnë për detyrat;

g) në mbledhje shqyrtohen me hollësi të gjitha problemet dhe çështjet e parashtruara, sipas rendit të ditës, por anëtarët kanë të drejtën e propozimit për të diskutuar edhe çështje të tjera;



gj) në përfundim të mbledhjes, mbahet procesverbal nga sekretariati teknik, i cili firmoset nga të gjithë anëtarët dhe kryetari;

h) në procesverbal mbahet shënim lista e pjesëmarrësve në mbledhje, si dhe emrat e anëtarëve që nuk kanë marrë pjesë, të cilët duhet të njoftojnë me shkrim arsyet e mospjesëmarrjes;

i) Këshilli vendos me shumicën e votave, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të tij;

j) pas çdo mbledhjeje, publiku informohet përmes një njoftimi në faqen zyrtare të bashkisë përkatëse për datën e mbledhjes, pjesëmarrjen, çështjet e shqyrtuara në rendin e ditës dhe përmbledhjen e diskutimeve;

k) publikimi i njoftimit bëhet brenda 3 (tri) ditëve pune nga zhvillimi i mbledhjes.

10. Vendimet e marra në Këshillin Vendor të Sigurisë Publike dërgohen pranë prefektit të qarkut, brenda 3 (tri) ditëve pune nga marrja e tyre.

11. Prefekti i qarkut, pas çdo vendimi të marrë nga Këshilli Vendor i Sigurisë Publike, informon Këshillin Kombëtar të Sigurisë në Komunitet.

12. Këshilli Kombëtar për Sigurinë në Komunitet funksionon si organ kolegjal, i cili kryesohet nga zëvendësministri i Brendshëm dhe ka në përbërje përfaqësues:

Në nivel zëvendësministri nga:

- a) Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- b) Ministria e Arsimit dhe Sportit;
- c) Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;
- ç) Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit;

- d) Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- dh) Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;

- e) Ministria e Drejtësisë.

Në nivel drejtor kabineti ose këshilltari nga:

- a) ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët;
- b) ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor.

13. Kryetari i Këshillit Kombëtar për Sigurinë në Komunitet mund të ftojë në mbledhjet e tij përfaqësues nga:

- a) Prokuroria së Përgjithshme;
- b) Avokati i Popullit;
- c) Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi;
- ç) Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
- d) komunitetet fetare;
- dh) organizatat e shoqërisë civile.

14. Përgjegjësitë e kryetarit të Këshillit Kombëtar për Sigurinë në Komunitet janë:

a) thërret dhe drejton mbledhjet e Këshillit Kombëtar për Sigurinë në Komunitet, si rregull 2 (dy) herë në vit;

b) miraton rendin e ditës dhe raportin përfundimtar të mbledhjeve;

c) informon ministrin e Brendshëm për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar për Sigurinë në Komunitet;

ç) prezanton raportin vjetor të Këshillit Kombëtar për Sigurinë në Komunitet pranë ministrit të Brendshëm.

15. Detyrat dhe përgjegjësitë e Këshillit Kombëtar për Sigurinë në Komunitet janë, si më poshtë vijon:

a) shqyrton përmes raporteve problematikat e identifikuar nga këshillat vendorë të sigurisë publike, me qëllim zgjidhjen e tyre pranë institucioneve përkatëse shtetërore qendrore;

b) kërkon raportim për realizimin e planit vjetor të punës nga këshillat vendorë të sigurisë publike;

c) relaton nëpërmjet raporteve dhe analizave te ministri i Brendshëm nevojën për hartimin e politikave të caktuara në fushën e sigurisë publike;

ç) orienton Këshillin Vendor të Sigurisë Publike për aplikimin dhe përfshirjen e praktikave më të mira në trajtimin e çështjeve të sigurisë në komunitet;

d) rekomandon Këshillin Vendor të Sigurisë Publike për zbatimin, në mënyrë të njëjtë, të politikave kombëtare në fushën e sigurisë;

dh) garanton marrëdhënie bashkëpunimi të ndërsjellë me Këshillin Vendor të Sigurisë Publike.

16. Drejtorja e Politikave të Rendit dhe Sigurisë Publike në Ministrinë e Brendshme, në rolin e sekretariatit teknik të Këshillit Kombëtar të Sigurisë në Komunitet, ushtron këto detyra:

a) përgjigjet për mbarrëvajtjen e veprimtarisë së këshillit nga ana logjistike dhe administrative;

b) mban, ruan dhe përditëson të gjitha kontaktet e anëtarëve të këshillit;

c) organizon dhe bën koordinimin e mbledhjeve të këshillit;

ç) njofton anëtarët për mbledhjen e radhës;

d) përgatit materialet përkatëse paraprake të mbledhjes, sipas rendit të ditës për anëtarët;

dh) merr pjesë në mbledhjet e këshillit duke mbajtur minutat e takimit;



e) shkëmben informacionin dhe materialet e mbledhjes, midis anëtarëve;

ë) harton procesverbalet e mbledhjes dhe raportet;

f) mban listën e personave të pranishëm në mbledhje;

g) protokollon dhe mban arkivin e procesverbaleve të mbledhjeve.

17. Këshilli Kombëtar i Sigurisë në Komunitet zhvillon mbledhjet, në bazë të rendit të ditës, të miratuar nga kryetari, sipas procedurës së mëposhtme:

a) njoftimi për datën e zhvillimit të mbledhjes dërgohet të paktën 5 (pesë) ditë pune përpara datës së përcaktuar, me shkresë zyrtare ose në formë elektronike, për të cilën anëtarët kanë rënë dakord;

b) anëtarët njoftohen paraprakisht edhe për rendin e ditës dhe për çdo informacion tjetër të nevojshëm;

c) në përcaktimin e çështjeve të rendit të ditës mund të kontribuojnë edhe anëtarët;

ç) mbledhjet mbahen kur janë prezentë më shumë se gjysma e anëtarëve të përhershëm të këshillit. Në rastet kur ky numër nuk plotësohet, mbledhja shtyhet në një datë tjetër, por jo më vonë se 3 (tri) ditë pune;

d) mbledhja hapet dhe drejtohet nga kryetari, i cili bën edhe prezantimin e rendit të ditës, si dhe një përmbledhje të zhvillimeve të fundit të punës së këshillit;

dh) kryetari drejton diskutimin, përcakton fillimin dhe përfundimin e shqyrtimit të secilës çështje të rendit të ditës;

e) anëtarët diskutojnë në bazë të rendit të ditës;

ë) në mbledhje shqyrtohen me hollësi të gjitha problemet dhe çështjet e parashtruara sipas rendit të ditës, por anëtarët kanë të drejtën e propozimit të çështjeve të tjera për diskutim;

f) në përfundim të mbledhjes, mbahet procesverbal nga sekretariati teknik, i cili firmoset nga të gjithë anëtarët dhe kryetari;

g) në procesverbal mbahet shënim lista e pjesëmarrësve në mbledhje, përfshirë edhe emrat e anëtarëve që nuk kanë marrë pjesë, të cilët duhet njoftojnë me shkrim arsyet e mospjesëmarrjes;

gi) vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje.

18. Këshillat vendorë të sigurisë publike dhe Këshilli Kombëtar për Sigurinë në Komunitet ngrihen brenda 3 (tre) muajve nga botimi i këtij vendimi në Fletoren Zyrtare.

19. Ngarkohen prefekti i qarkut, institucionet e përmendura në pikat 2 dhe 12, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

UDHËZIM
Nr. 27, datë 23.10.2024

**PËR DISA NDRYSHIME NË
UDHËZIMIN NR. 21, DATË 25.11.2010,
“MBI KËRKESAT SPECIFIKE TË
HIGJENËS DHE KONTROLLET
ZYRTARE PËR PRODUKTET ME
ORIGINË SHTAZORE”,
TË NDRYSHUAR¹**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, si dhe në zbatim të nenit 38, të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, “Për ushqimin”, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 21, datë 25.11.2010, “Për kërkesat specifike të higjienës dhe kontrollet zyrtare për produktet me origjinë shtazore”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:

1. Kërkesat specifike të higjienës të operatorëve të biznesit ushqimor, germa A – kërkesat e higjienës për operatorët e biznesit ushqimor që merren me vezët dhe produktet e vezëve të udhëzimit nr. 2, datë 25.11.2010, “Mbi kërkesat specifike të higjienës dhe kontrollet zyrtare për produktet me origjinë shtazore”, ndryshon si më poshtë:

**VEZËT DHE PRODUKTET E VEZËVE
KAPITULLI I. VEZËT**

1. Në ambientet e prodhuesit dhe deri në shitjen te konsumatori, vezët duhet të mbahen të pastra, të thata dhe pa erë të jashtme, të mbrojtura efektivisht nga goditjet dhe nga rrezet direkte të diellit.

¹ Ky udhëzim është përafruar pjesërisht me rregulloren (KE) nr. 853/2004, të Parlamentit dhe të Këshillit Evropian
Faqe | 20802

të 29 prillit 2004, “Përcaktimin e rregullave të veçanta të higjienës për ushqimet me origjinë shtazore”.



2. Vezët duhet të ruhen dhe transportohen deri në shitje te konsumatori përfundimtar në një temperaturë, mundësisht konstante, e cila është më e përshtatshme për të siguruar ruajtjen optimale të vetive të tyre higjienike, përveç rasteve kur autoriteti kompetent vendos kërkesat kombëtare të temperaturës për objektet e magazinimit të vezëve dhe për automjetet që transportojnë vezët ndërmjet objekteve të tilla magazinimi.

3. Vezët duhet t'i dorëzohen konsumatorit brenda një afati kohor maksimal prej 28 ditësh nga pjellja.

4. Për vezët e prodhuara nga pulat e species *Gallus gallus*, "Data e jetëgjatësisë minimale", siç përcaktohet në nenin 3, pika 2, të vendimin nr. 434, datë 11.7.2018, "Për etiketimin e ushqimeve dhe informimin e konsumatorit", duhet të jetë jo më shumë se 28 ditë pas pjelljes. Kur tregohet periudha e pjelljes, kjo datë do të përcaktohet nga dita e parë e asaj periudhe.

KAPITULLI II. PRODUKTET E VEZËVE

I. KËRKESAT PËR STABILIMENTET

Operatorët e biznesit të ushqimit duhet të sigurojnë që stabilimentet për prodhimin e produkteve të vezëve janë ndërtuar, shtruar dhe pajisur, në mënyrë që të sigurojnë ndarjen e operacioneve të mëposhtme:

1. larja, tharja dhe dezinfektimi i vezëve të pista, ku është kryer;

2. thyerja e vezëve, mbledhja e përmbajtjes së tyre dhe heqja e pjesëve të lëvizshme dhe membranave;

3. operacione të ndryshme nga ato të përmendura në pikat 1 dhe 2.

II. LËNDËT E PARA PËR PRODHIMIN E PRODUKTEVE TË VEZËVE

Operatorët e biznesit të ushqimit duhet të sigurojnë që lëndët e para të përdorura për prodhimin e produkteve të vezëve të jenë në përputhje me kërkesat e mëposhtme:

1. Lëvizshat e vezëve të përdorura në prodhimin e produkteve të vezëve duhet të jenë plotësisht të zhvilluara dhe të mos kenë thyerje. Megjithatë, vezët e plasaritura mund të përdoren për prodhimin e vezëve të lëngëta ose produkteve të vezëve nëse stabilimenti i prodhimit ose qendra e paketimit i dorëzon ato drejtpërdrejt në një stabiliment të miratuar për prodhimin e vezëve të lëngshme ose një stabiliment përpunimi, ku ato duhet të thyhen sa më shpejt që të jetë e mundur.

2. Veza e lëngshme e përfutur në një stabiliment i miratuar për këtë qëllim mund të përdoret si lëndë e parë. Veza e lëngshme duhet të përfutohet në përputhje me kërkesat e pikave 1, 2, 3, 4 dhe 7 të pjesës III.

III. KËRKESA TË VEÇANTA HIGJIENE PËR PRODHIMIN E PRODUKTEVE TË VEZËVE

Operatorët e biznesit të ushqimit duhet të sigurojnë që të gjitha operacionet të kryhen në mënyrë të tillë që të shmanget çdo kontaminim gjatë prodhimit, trajtimit dhe magazinimit të produkteve të vezëve, veçanërisht duke siguruar përputhjen me kërkesat e mëposhtme:

1. Vezët nuk duhet të thyhen nëse nuk janë të pastra dhe të thata.

2. Vezët duhet të thyhen në një mënyrë që të minimizojë kontaminimin, veçanërisht duke siguruar ndarjen e duhur nga operacionet e tjera. Vezët e plasaritura duhet të përpunohen sa më shpejt që të jetë e mundur.

3. Vezët e ndryshme nga ato të pulave, gjelave të detit ose shpendëve të detit duhet të trajtohen dhe përpunohen veçmas. Të gjitha pajisjet duhet të pastrohen dhe dezinfektohen përpara se të rifillojë përpunimi i vezëve të pulave, gjelave të detit dhe shpendëve të detit.

4. Përmbajtja e vezëve nuk mund të merret nga centrifugimi ose shtypja e vezëve, as centrifugimi nuk mund të përdoret për të marrë mbetjet e të bardhave të vezëve nga lëvizshat e zbrazëta për konsum njerëzor.

5. Pas thyerjes, çdo grimcë e vezës së lëngshme duhet t'i nënshtrohet përpunimit sa më shpejt që të jetë e mundur për të eliminuar rreziqet mikrobiologjike ose për t'i reduktuar ato në një nivel të pranueshëm. Një grup që është përpunuar në mënyrë të pamjaftueshme mund t'i nënshtrohet menjëherë përpunimit përsëri në të njëjtën stabiliment nëse ky përpunim e bën atë të përshtatshëm për konsum njerëzor. Kur një grup rezulton të jetë i papërshtatshëm për konsum njerëzor, ai duhet të denatyrohet për të siguruar që të mos përdoret për konsum njerëzor.

6. Nuk kërkohet përpunim për të bardhën e vezës të destinuar për prodhimin e albuminës së tharë ose të kristalizuar, e destinuar më pas t'i nënshtrohet trajtimit termik.

7. Nëse përpunimi nuk kryhet menjëherë pas thyerjes, veza e lëngshme duhet të ruhet ose e ngrirë



ose në një temperaturë jo më të madhe se 4°C. Periudha e ruajtjes para përpunimit në 4°C nuk duhet të kalojë 48 orë. Megjithatë, këto kërkesa nuk zbatohen për produktet që do të jenë të desheguara, nëse procesi i heqjes së sheqerit kryhet sa më shpejt që të jetë e mundur.

8. Produktet që nuk janë stabilizuar, në mënyrë që të mbahen në temperaturën e dhomës duhet të ftohen në jo më shumë se 4°C. Produktet për ngrirje duhet të ngrihen menjëherë pas përpunimit.

IV. SPECIFIKIMET ANALITIKE

1. Përqendrimi i acidit 3-OH-butirik nuk duhet të kalojë 10 mg/kg në lëndën e thatë të produktit të pamodifikuar të vezës.

2. Përmbajtja e acidit laktik në lëndën e parë të përdorur për prodhimin e produkteve të vezëve nuk duhet të kalojë 1 g/kg lëndë të thatë. Megjithatë, për produktet e fermentuara, kjo vlerë duhet të jetë ajo e regjistruar përpara procesit të fermentimit.

3. Sasia e mbetjeve të lëvozhgave të vezëve, membranave të vezëve dhe çdo grimce tjetër në produktin e vezës së përpunuar nuk duhet të kalojë 100 mg/kg produkt vezë.

V. ETIKETIMI DHE VULA E IDENTIFIKIMIT

1. Përveç kërkesave të përgjithshme për shenjën/vulën identifikuese të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, dërgesat e produkteve të vezëve, të destinuara jo për shitje me pakicë, por për përdorim si përbërës në prodhimin e një produkti tjetër, duhet të kenë një etiketë që tregon temperaturën në të cilat produktet e vezëve duhet të ruhen dhe në periudhën gjatë së cilës mund të sigurohet konservimi.

2. Në rastin e vezës së lëngshme, etiketa e përmendur në pikën 1 duhet të ketë, gjithashtu, fjalët: “Vezë të lëngshme jo të pasterizuar – për t’u trajtuar në vendin e destinacionit” dhe të tregojë datën dhe orën e thyerjes.

Germa D. Kërkesat e higjienës për operatorët e biznesit ushqimor që merren me stomakë të trajtuar, fshikëza dhe zorrë e udhëzimit nr. 2, datë 25.11.2010, “Mbi kërkesat specifike të higjienës dhe kontrollat zyrtare për produktet me origjinë shtazore”, ndryshon si më poshtë:

STOMAKËT E TRAJTUAR, FSHIKËZAT DHE ZORRËT

Operatorët e biznesit ushqimor që trajtojnë stomakun, fshikëzën dhe zorrët duhet të sigurojnë përputhjen me kërkesat e mëposhtme:

1. Zorrët, fshikëzat dhe stomaku i kafshëve mund të vendosen vetëm në treg, nëse:

a) ato rrjedhin nga kafshët të cilat janë therur në një thertore dhe të cilat janë gjetur të përshtatshme për konsum njerëzor pas inspektimit *ante-mortem* dhe *post-mortem*;

b) ato të jenë kriposur, trajtuar me nxehtë ose tharë; dhe

c) pas trajtimit të përmendur në pikën (b), merren masa efektive për të parandaluar rikontaminimin.

2. Stomakët e trajtuar, fshikëzat dhe zorrët që nuk mund të mbahen në temperaturën e ambientit duhet të ruhen të ftohta duke përdorur pajisjet e destinuara për këtë qëllim deri në dërgimin e tyre. Në veçanti produktet që nuk janë të kripara ose të thara duhet të mbahen në një temperaturë jo më të madhe se 3°C.

Germa E. Kërkesat e higjienës për operatorët e biznesit që merren me xhelatinë dhe kolagjen të udhëzimit nr. 2, datë 25.11.2010, “Mbi kërkesat specifike të higjienës dhe kontrollat zyrtare për produktet me origjinë shtazore”, ndryshon si më poshtë:

XHELATINA

1. Operatorët e biznesit ushqimor që prodhojnë xhelatinë duhet të sigurojnë përputhjen me kërkesat e këtij seksioni.

2. Për qëllimet e këtij seksioni, “regjie” nënkupton ngurtësimin e lëkurës, duke përdorur agentë për rrezitje vegjetale, kripëra kromi ose substanca të tjera, si: kripërat e aluminit, kripërat e hekurit, kripërat silicike, aldehidet dhe kinonet, ose agentë të tjerë forcues sintetikë.

KAPITULLI I. KËRKESAT PËR LËNDËT E PARA

1. Për prodhimin e xhelatinës së destinuar për përdorim në ushqim, mund të përdoren lëndët e para të mëposhtme:

a) kockat, të ndryshme nga materialet e specifikuar të rrezikut siç përcaktohet në urdhrin nr. 220, datë 14.4.2016, “Për miratimin e rregullores Për përcaktimin e rregullave për parandalimin, kontrollin dhe çrrënjosjen e encefalopative spongiforme të transmetueshme”;



b) lëkurët dhe lëkurat e kafshëve ripërtypëse të kultivuara;

c) lëkurat e derrit;

d) lëkura e shpendëve;

e) tendinat dhe ligamentet;

f) gëzofi dhe lëkura e kafshëve të egra të gjahut; dhe

g) lëkurën dhe kockat e peshkut.

2. Ndalohet përdorimi i gëzofëve dhe lëkurave nëse ato i janë nënshtruar ndonjë procesi regjie, pavarësisht nëse ky proces ka përfunduar.

3. Lëndët e para të listuara në pikat 1 (a) deri (e) duhet të rrjedhin nga kafshët që janë therur në një thertore dhe kufomat e të cilave janë gjetur të përshtatshme për konsum njerëzor pas inspektimit *ante-mortem* dhe *post-mortem* (para dhe pas therjes) ose në rastin prej gëzofësh dhe lëkurash nga kafshë të egra të gjahut, të gjetura të përshtatshme për konsum njerëzor.

4. a) Lëndët e para që nuk kanë pësuar asnjë trajtim me konservant përveç ftohjes, ngrirjes ose ngrirjes së shpejtë, duhet të vijnë nga stabilimente të regjistruara ose të licencuara në përputhje me legjislacionin në fuqi.

b) Lëndët e para të trajtuara të mëposhtme mund të përdoren:

i. kockat të ndryshme nga materiali me risk të specifikuar siç përcaktohet në urdhrin nr. 220, datë 14.4.2016, “Për miratimin e rregullores ‘Për përcaktimin e rregullave për parandalimin, kontrollin dhe çrrënjosjen e encefalopative spongiforme të transmetueshme’”, që vijnë nga stabilimente nën kontrollin dhe të listuara nga autoriteti kompetent dhe që janë nënshtruar në një prej trajtimeve të mëposhtme:

- grimcuar në copa përafërsisht 15 mm dhe lyhet me ujë të nxehtë në një temperaturë minimale 70°C për të paktën 30 minuta, minimumi 80°C për të paktën 15 minuta ose minimumi 90°C për të paktën 10 minuta, dhe më pas ndahet dhe më pas lahet dhe thahet për të paktën 20 minuta në një rrymë ajri të nxehtë me një temperaturë fillestare minimale 350°C, ose për 15 minuta në një rrjedhë ajri të nxehtë me një temperaturë fillestare prej më shumë se 700°C;

- tharë në diell për një minimum prej 42 ditësh në një temperaturë mesatare prej të paktën 20°C;

- trajtim me acid të tillë që pH të mbahet në më pak se 6 në thelb për të paktën 1 orë para tharjes;

ii. gëzofët dhe lëkurat e kafshëve ripërtypëse të kultivuara, lëkurat e derrit, lëkurat e shpendëve dhe gëzofët dhe lëkurat e kafshëve të egra që vijnë nga stabilimente nën kontrollin dhe të listuara nga autoriteti kompetent dhe që i janë nënshtruar një prej trajtimeve të mëposhtme:

- trajtimi me alkali për të vendosur një pH > 12 në thelb, i ndjekur nga kriposja për të paktën 7 ditë;

- tharje për të paktën 42 ditë në një temperaturë prej të paktën 20°C;

- trajtim me acid në mënyrë të tillë që pH të mbahet në më pak se 5 në thelb për të paktën 1 orë;

- trajtimi me alkali në një pH > 12 për të paktën 8 orë;

iii) kockat e ndryshme nga materiali me rrezik të përcaktuar në urdhrin nr. 220, datë 14.4.2016, “Për miratimin e rregullores ‘Për përcaktimin e rregullave për parandalimin, kontrollin dhe çrrënjosjen e encefalopative spongiforme të transmetueshme’”, gëzofët dhe lëkurat e kafshëve ripërtypëse të kultivuara, lëkurën e derrit, lëkurën e shpendëve, lëkurën e peshkut dhe gëzofin dhe lëkurën e kafshëve të egra të gjahut dhe lëkurat që kanë pësuar ndonjë trajtim tjetër përveç atyre të specifikuar në pikën (i) ose (ii) dhe që vijnë nga stabilimente të regjistruara ose të licencuara në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Për qëllimet e 2 pikave të para të pikës (b) (ii), kohëzgjatja e trajtimeve mund të përfshijë kohën e transportit.

Lëndët e para të trajtuara të referuara në pikat (b) (i) dhe (b) (ii) duhet të rrjedhin nga:

- kafshë ripërtypëse shtëpiake dhe të kultivuara, derrat dhe shpendët që janë therur në një thertore dhe karkasat e të cilave janë të përshtatshme për konsum njerëzor pas inspektimit *ante-* dhe *post-mortem*; ose

- nga kafshë të egra gjahu të vrarë, karkasat e të cilit janë gjetur të përshtatshme për konsum nga inspektimi *ante-post mortum* (para dhe pas therjes).

5. Qendrat e grumbullimit dhe fabrikat e lëkurës mund të furnizojnë gjithashtu me lëndë të parë për prodhimin e xhelatinës së destinuar për konsum njerëzor nëse autoriteti kompetent i autorizon ato në mënyrë specifike për këtë qëllim dhe ato plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

a) ato duhet të kenë dhoma magazinimi me dysHEME të forta dhe mure të lëmuara që pastrohen dhe dezinfektohen lehtë dhe sipas rastit, të pajisura me pajisje ftohjeje;



b) dhomat e magazinimit duhet të mbahen në një gjendje të kënaqshme pastërtie dhe riparimi, në mënyrë që të mos përbëjnë një burim ndotjeje/kontaminimi për lëndët e para;

c) nëse ruhet lënda e parë që nuk është në përputhje me këtë udhëzim dhe/ose përpunohet në këto ambiente, duhet të ndahet nga lënda e parë që është në përputhje me këtë udhëzim gjatë gjithë periudhës së marrjes, ruajtjes, përpunimit dhe dërgimit.

KAPITULLI II. TRANSPORTI DHE RUAJTJA E LËNDËVE TË PARA

1. Në vend të shenjës së identifikimit të parashikuar në legjislacionin në fuqi, një dokument që tregon vendndodhjen e origjinës dhe që përmban informacionin e përcaktuar në shtojcën I, duhet të shoqërojë lëndët e para gjatë transportit, kur dorëzohen në një qendër grumbullimi ose fabrikë lëkurësh dhe kur dorëzohet në stabiliment të përpunimit të xhelatinës.

2. Lëndët e para duhet të transportohen dhe ruhen të ftohta ose të ngrira, përveç rasteve kur ato përpunohen brenda 24 orëve pas nisjes së tyre. Megjithatë, kockat ose osseina të lyera dhe të thara, lëkurat e kripura, të thara dhe gëlqerore, gëzofët dhe lëkurat e trajtuara me alkali ose acid mund të transportohen dhe ruhen në temperaturën e ambientit.

3. Pas kontrolleve veterinarë të parashikuara në legjislacionin në fuqi për kontrollet në Pikat e Inspektimit Kufitar, lëndët e para për prodhimin e xhelatinës për konsum njerëzor, për të cilat certifikimi i shëndetit të kafshëve kërkohet, duhet të transportohet direkt në stabilimentin në vendin e destinacionit.

Të gjitha masat paraprake duke përfshirë asgjësimin e sigurt të nënprodukteve shtazore, mbeturinave, materialeve të papërdorura ose të tepërta, duhet të merren për të shmangur rreziqet e përhapjes së sëmundjeve të kafshët.

KAPITULLI III. KËRKESAT PËR PRODHIMIN E XHELATINËS

1. Procesi i prodhimit të xhelatinës duhet të sigurojë, që:

a) i gjithë materiali kockor i ripërtypësve që rrjedh nga kafshë të lindura, të rritura ose të thërra në vende ose rajone me rrezik të kontrolluar ose të papërcaktuar të BSE-së në përputhje me legjislacionin në fuqi në këtë fushë, i nënshtrohet një procesi që siguron që i gjithë materiali kockor të

grimcohet imët dhe të degreasohet me ujë të nxehtë dhe trajtohet me acid klorhidrik të holluar (në përqendrim minimal prej 4 % dhe pH < 1,5) për një periudhë prej të paktën dy ditësh. Ky trajtim ndiqet ose nga:

- një trajtim alkalik i tretësirës së ngopur gëlqereje (pH > 12,5) për një periudhë prej të paktën 20 ditësh me një hap trajtimi termik prej të paktën 138°C për të paktën katër sekonda; ose

- një trajtim me acid (pH < 3,5) gjatë minimumi 10 orë me një hap trajtimi termik prej minimumi 138°C për të paktën katër sekonda; ose

- një proces ngrohjeje dhe presioni për të paktën 20 minuta me avull të ngopur prej 133°C në më shumë se 3 bare; ose

- çdo proces ekuivalent të miratuar;

b) lënda tjetër e parë i nënshtrohet një trajtimi me acid ose alkali, i ndjekur nga një ose më shumë shpëlarje. PH duhet të rregullohet më pas.

Xhelatina duhet të nxirret duke ngrohur një ose më shumë herë radhazi, e ndjekur nga pastrimi me anë të filtrimit dhe trajtimit termik.

2. Një operator biznesi ushqimor mund të prodhojë dhe ruajë si xhelatinë të destinuar për konsum njerëzor ashtu edhe xhelatinë që nuk është e destinuar për konsum njerëzor në të njëjtën stabiliment, me kusht që lëndët e para dhe procesi i prodhimit të jenë në përputhje me kërkesat që zbatohen për xhelatinën e destinuar për konsum njerëzor.

KAPITULLI IV. KËRKESAT PËR PRODUKTET TË PËRFUNDUARA

Operatorët e biznesit të ushqimit duhet të sigurojnë që xhelatina të përputhet me kufijtë e mbetjeve të përcaktuara në tabelën e mëposhtme.

Mbetje	Limitet/kufiri
As	1 ppm
Pb	5 ppm
Cd	0,5 ppm
Hg	0,15 ppm
Cr	10 ppm
Cu	30 ppm
Zn	50 ppm
SO ₂ (Farmakopeja Evropiane, botimi i fundit)	50 ppm
H ₂ O ₂ (Farmakopeja Evropiane, botimi i fundit)	10 ppm



KAPITULLI V. ETIKETIMI

Ambalazhimi dhe paketimi që përmban xhelatinë duhet të ketë fjalët “Xhelatinë e përshtatshme për konsum njerëzor” dhe duhet të tregojë datën e jetëgjatësisë minimale.

KOLAGJENI

1. Operatorët e biznesit ushqimor që prodhojnë kolagjen duhet të sigurojnë përputhjen me kërkesat e këtij udhëzimi. Pa paragjykuar dispozitat e tjera, produktet e përfituara nga kolagjeni duhet të bëhen nga kolagjeni që përputhet me kërkesat e këtij udhëzimi.

2. Për qëllimet e këtij udhëzimi, “regjie” nënkupton ngurtësimin e lëkurës duke përdorur agjentë për regjie vegjetale, kripëra kromi ose substanca të tjera, si: kripërat e aluminit, kripërat e hekurit, kripërat silicike, aldehidet dhe kinonet ose agjentë të tjerë forcues sintetikë.

KAPITULLI I. KËRKESAT PËR LËNDËT E PARA

1. Për prodhimin e kolagjenit të destinuar për përdorim në ushqim, mund të përdoren lëndët e para të mëposhtme:

a) kockat, të ndryshme nga materialet me rrezik specifik siç përcaktohet në urdhrin nr. 220, datë 14.4.2016, “Për miratimin e rregullores ‘Për përcaktimin e rregullave për parandalimin, kontrollin dhe çrrënjosjen e encefalopative spongiforme të transmetueshme’”;

b) gëzofët dhe lëkurat e kafshëve ripërtypëse të kultivuara;

c) lëkurat e derrit;

d) lëkura e shpendëve;

e) tendinat dhe ligamentet;

f) gëzofët dhe lëkurat e gjahut të egra; dhe

g) lëkurën dhe kockat e peshkut.

2. Ndalohet përdorimi i gëzofëve dhe lëkurave nëse ato i janë nënshtruar ndonjë procesi për regjie, pavarësisht nëse ky proces ka përfunduar.

3. Lëndët e para të listuara në pikat 1 (a) deri (d) duhet të rrjedhin nga kafshët që janë therur në një thertore dhe karkasat e të cilave janë gjetur të përshtatshme për konsum njerëzor pas inspektimit para dhe pas therjes (*ante- dhe post-mortem*) ose në rastin e lëkurave dhe gëzofëve të kafshëve të gjahut të egra, të gjetura të përshtatshme për konsum njerëzor.

4. a) Lëndët e para që nuk i janë nënshtruar ndonjë trajtimi konservues përveç ftohjes, ngrirjes ose ngrirjes së shpejtë duhet të vijnë nga stabilimente

të regjistruara ose të licencuara në përputhje me legjislacionin në fuqi.

b) Lëndët e para të trajtuara të mëposhtme mund të përdoren:

i) kockat të ndryshme nga materiali me risk të specifikuar siç përcaktohet në urdhrin nr. 220, datë 14.4.2016, “Për miratimin e rregullores ‘Për përcaktimin e rregullave për parandalimin, kontrollin dhe çrrënjosjen e encefalopative spongiforme të transmetueshme’”, që vijnë nga stabilimente nën kontrollin dhe të listuara nga autoriteti kompetent dhe që janë nënshtruar një prej trajtimeve të mëposhtme:

- grimcuar në copa përafërsisht 15 mm dhe lyhet me ujë të nxehtë në një temperaturë minimale 70°C për të paktën 30 minuta, minimumi 80°C për të paktën 15 minuta ose minimumi 90°C për të paktën 10 minuta, dhe më pas ndahet dhe më pas lahet dhe thahet për të paktën 20 minuta në një rrymë ajri të nxehtë me një temperaturë fillestare minimale 350°C, ose për 15 minuta në një rrjedhë ajri të nxehtë me një temperaturë fillestare prej më shumë se 700°C;

- tharë në diell për një minimum prej 42 ditësh në një temperaturë mesatare prej të paktën 20°C;

- trajtim me acid të tillë që pH të mbahet në më pak se 6 në thelb për të paktën 1 orë para tharjes;

ii) gëzofët dhe lëkurat e kafshëve ripërtypëse të kultivuara, lëkurat e derrit, lëkurat e shpendëve dhe gëzofët dhe lëkurat e kafshëve të egra që vijnë nga stabilimente nën kontrollin dhe të listuara nga autoriteti kompetent dhe që i janë nënshtruar një prej trajtimeve të mëposhtme:

- trajtimi me alkali për të vendosur një pH > 12 në thelb, i ndjekur nga kriposja për të paktën 7 ditë;

- tharje për të paktën 42 ditë në një temperaturë prej të paktën 20°C;

- trajtim me acid në mënyrë të tillë që pH të mbahet në më pak se 5 në thelb për të paktën 1 orë;

- trajtimi me alkali në një pH > 12 për të paktën 8 orë;

iii) kockat e ndryshme nga materiali me rrezik të specifikuar të përcaktuar në urdhrin nr. 220, datë 14.4.2016, “Për miratimin e rregullores ‘Për përcaktimin e rregullave për parandalimin, kontrollin dhe çrrënjosjen e encefalopative spongiforme të transmetueshme’”, gëzofët dhe lëkurat e kafshëve ripërtypëse të kultivuara, lëkurën e derrit, lëkurën e shpendëve, lëkurën e peshkut dhe gëzofin dhe lëkurën e kafshëve të egra të gjahut dhe



lëkurat që kanë pësuar ndonjë trajtim tjetër përveç atyre të specifikuar në pikat (i) ose (ii) dhe që vijnë nga stabilimente të regjistruara ose të licencuara në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Për qëllimet e 2 pikave të para të pikës (b) (ii), kohëzgjatja e trajtimeve mund të përfshijë kohën e transportit.

Lëndët e para të trajtuara të referuara në pikat (b) (i) dhe (b) (ii), duhet të rrjedhin nga:

- kafshë ripërtypëse shtëpiake dhe të kultivuara, derrat dhe shpendët që janë therur në një thertore dhe karkasat e të cilave janë të përshtatshme për konsum njerëzor pas inspektimit *ante-* dhe *post-mortem* (para dhe pas therjes); ose

- nga kafshë të egra gjahu të vrarë, karkasat e të cilit janë gjetur të përshtatshme për konsum nga inspektimi *ante-post mortem* (para dhe pas therjes).

5. Qendrat e grumbullimit dhe fabrikat e lëkurës mund të furnizojnë gjithashtu me lëndë të parë për prodhimin e kolagjenit të destinuar për konsum njerëzor nëse autoriteti kompetent i autorizon ato në mënyrë specifike për këtë qëllim dhe ato plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

- a) ato duhet të kenë dhoma magazinimi me dysheme të forta dhe mure të lëmuara që pastrohen dhe dezinfektohen lehtë dhe sipas rastit, të pajisura me pajisje ftohjeje;

- b) dhomat e magazinimit duhet të mbahen në një gjendje të kënaqshme pastërtie dhe riparimi, në mënyrë që të mos përbëjnë një burim ndotjeje për lëndët e para;

- c) nëse lënda e parë që nuk është në përputhje me këtë kapitull ruhet dhe/ose përpunohet në këto ambiente, ajo duhet të ndahet nga lënda e parë në përputhje me këtë udhëzim gjatë gjithë periudhës së marrjes, ruajtjes, përpunimit dhe dërgimit.

KAPITULLI II. TRANSPORTI DHE RUAJTJA E LËNDËVE TË PARA

1. Në vend të shenjës së identifikimit të parashikuar në legjislacionin në fuqi, një dokument që tregon vendndodhjen e origjinës dhe që përmban informacionin e përcaktuar në shtojcën I, duhet të shoqërojë lëndët e para gjatë transportit, kur dorëzohen në një qendër grumbullimi ose fabrikë lëkurësh dhe kur dorëzohet në stabiliment të përpunimit të kolagjenit.

2. Lëndët e para duhet të transportohen dhe ruhen të ftohta ose të ngrira, përveç rasteve kur ato përpunohen brenda 24 orëve pas nisjes së tyre. Megjithatë, kockat ose osseina të lyera dhe të thara,

lëkurat e kripura, të thara dhe gëlqere, dhe lëkurat e trajtuara me alkali ose acid mund të transportohen dhe ruhen në temperaturën e ambientit.

3. Pas kontrolleve veterinarë të parashikuara në legjislacionin në fuqi për kontrollet në pikat e inspektimit kufitar, lëndët e para për prodhimin e kolagjenit për konsum njerëzor, për të cilat certifikimi i shëndetit të kafshëve kërkohet, duhet të transportohet direkt në stabilimentin në vendin e destinacionit. Të gjitha masat paraprake, duke përfshirë asgjësimin e sigurt të nënprodukteve shtazore jo për konsum njerëzor, mbeturinave, materialeve të papërdorura ose të tepërta, duhet të merren për të shmangur rreziqet e përhapjes së sëmundjeve të kafshët.

KAPITULLI III. KËRKESAT PËR PRODHIMIN E KOLAGJENIT

1. Procesi i prodhimit të kolagjenit, duhet të sigurojë, që:

- a) i gjithë materiali kockor i ripërtypësve që rrjedh nga kafshë të lindura, të rritura ose të thera në vende ose rajone me rrezik të kontrolluar ose të papërcaktuar të BSE-së në përputhje me urdhrin nr. 220, datë 14.4.2016, “Për miratimin e rregullores ‘Për përcaktimin e rregullave për parandalimin, kontrollin dhe çrrënjosjen e encefalopative spongiforme të transmetueshme’”, i nënshtrohet një procesi që siguron që i gjithë materiali kockor të grimcohet imët dhe të degreasohet me ujë të nxehtë dhe trajtohet me acid klorhidrik të holluar (në përqendrim minimal prej 4 % dhe pH < 1,5) për një periudhë prej të paktën 2 ditësh. Ky trajtim duhet të pasohet nga rregullimi i pH, duke përdorur acid ose alkali i ndjekur nga:

- i) një ose më shumë shpëlarje dhe të paktën një nga proceset e mëposhtme:

- filtrim;
- bluarje;
- nxjerrje;

- ii) ose ndonjë proces ekuivalent të miratuar;

- b) lëndët e para të ndryshme nga ato të përmendura në pikën (a) duhet t’i nënshtrohen një trajtimi që përfshin larje, rregullim të pH, duke përdorur acid ose alkali i ndjekur nga:

- i) një ose më shumë shpëlarje dhe të paktën një nga proceset e mëposhtme:

- filtrim;
- bluarje;
- nxjerrje;

- ii) ose ndonjë proces ekuivalent të miratuar.



2. Pasi t'i nënshtrohet procesit të përmendur në pikën 1, kolagjeni mund t'i nënshtrohet një procesi tharjeje.

3. Operatori i biznesit ushqimor mund të prodhojë dhe ruajë kolagjinin e destinuar për konsum njerëzor dhe kolagjinin jo të destinuar për konsum njerëzor në të njëjtën stabiliment, me kusht që lëndët e para dhe procesi i prodhimit të jenë në përputhje me kërkesat që zbatohen për kolagjinin e destinuar për konsum njerëzor.

KAPITULLI IV. KËRKESAT PËR PRODUKTET E PËRFUNDUARA

Operatorët e biznesit të ushqimit duhet të sigurojnë që kolagjeni të përputhet me kufijtë e mbetjeve të përcaktuara në tabelën e mëposhtme:

Mbetje	Limitet/kufiri
As	1 ppm
Pb	5 ppm
Cd	0,5 ppm
Hg	0,15 ppm
Cr	10 ppm
Cu	30 ppm
Zn	50 ppm
SO ₂ (Farmakopeja Evropiane, botimi i fundit)	50 ppm
H ₂ O ₂ (Farmakopeja Evropiane, botimi i fundit)	10 ppm

KAPITULLI V: ETIKETIMI

Ambalazhimi dhe paketimi që përmban kolagjen duhet të ketë fjalët “Kolagjen i përshtatshëm për konsum njerëzor” dhe të tregojë datën e përgatitjes.

PRODUKTET SHUMË TË RAFINUARA

1. Operatorët e biznesit ushqimor që prodhojnë produktet e mëposhtme shumë të rafinuara me origjinë shtazore duhet të sigurojnë që trajtimi i lëndëve të para të përdorura eliminon çdo rrezik për kafshët ose shëndetin publik:

- sulfat kondroitin;
- acidi hialuronik;
- produkte të tjera të hidrolizuara të kërcit;
- kitozan;
- glukozaminë;
- mullëza;

g) xhelatina e peshkut;

h) aminoacidet që janë të autorizuar si aditivë ushqimorë në përputhje me udhëzim nr. 18, datë 9.11.2022, “Për aditivët ushqimorë të lejuar”;

i) aromatizuesit ushqimorë që janë të autorizuar në përputhje me legjislacionin në fuqi (2);

j) derivatet e yndyrës.

2. Lëndët e para të përdorura për prodhimin e produkteve shumë të rafinuara të përmendura në pikën 1 duhet të rrjedhin nga:

a) kafshët duke përfshirë pendët e tyre, të cilat janë therur në një thertore dhe mishi i të cilave është gjetur i përshtatshëm për konsum njerëzor pas inspektimit para dhe pas therjes; ose

b) produktet e peshkimit që përputhen me udhëzimin nr. 25, datë 25.11.2010, “Për kushtet higjienike dhe kontrollet për molusqet e gjalla bivalvore, peshkun dhe produktet e peshkimit”; ose

c) yndyrat dhe fijet e përpunuara që përputhen me udhëzim nr. 21, data 25.11.2010, “Mbi kërkesat specifike të higjienës dhe kontrollet zyrtare për produktet me origjinë shtazore” ose leshin, nëse këto produkte i nënshtrohen njërit prej proceseve të mëposhtme:

1) transesterifikimi ose hidroliza në një temperaturë prej të paktën 200°C, nën presionin përkatës, për të paktën 20 minuta (glicerinë, acide yndyrore dhe estere);

2) saponifikimi me NaOH 12M:

- në një proces grumbull në 95°C për tri orë; ose

- në një proces të vazhdueshëm në 140°C 2 bar (2 000 hPa) për tetë minuta; ose

3) hidrogjenizimi në 160°C në 12 bar (12 000 hPa) për 20 minuta.

Flokët e njeriut nuk mund të përdoren si burim për prodhimin e aminoacideve.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj



SHTOJCË I

MODEL DOCUMENT TO ACCOMPANY RAW MATERIAL DESTINED FOR THE
PRODUCTION OF GELATINE OR COLLAGEN INTENDED FOR HUMAN
CONSUMPTIONMODELI I DOKUMENTIT QË SHOQËRON LËNDËN E PARË TË DESTINUAR PËR
PRODHIMIN E XHELATINËS OSE KOLAGJENIT TË DESTINUAR PËR KONSUM
NJERËZOR*Number of the commercial document:*

Numri i dokumentit tregtar:

I. Identification of raw material**I. Identifikimi i lëndës së parë***Nature of the raw material:*

Natyra e lëndës së parë:

Animal species:

Llojet e kafshëve:

Type of packaging:

Lloji i paketimit:

Number of packages:

Numri i paketave:

Net weight (kg):

Pesha neto (kg):

II. Origin of raw material**II. Origjina e lëndës së parë***Type, name, address and approval/registration/special authorisation number of the establishment of origin:*Lloji, emri, adresa dhe numri i miratimit/regjistrimit/autorizimit të posaçëm të stabilimentit të
originës:*Name and address of the consignor (1):*

Emri dhe adresa e dërguesit (1):

III. Destination of raw material**III. Destinacioni i lëndës së parë***Type, name, address and approval/registration/special authorisation number of the production establishment of
destination:*Lloji, emri, adresa dhe numri i miratimit/regjistrimit/autorizimit të posaçëm të stabilimentit prodhues
të destinacionit:*Name and address of the consignee (2):*

Emri dhe adresa e marrësit (2):

IV. Means of transport:

IV. Mjetet e transportit:

Done at,, on

Bërë në,, më

*(Signature of the operator of the establishment of origin or its representatives.)**(Nënshkrimi i operatorit të stabilimentit të origjinës ose përfaqësuesve të tij.)*

**URDHËR****Nr. 542, datë 25.10.2024****PËR DELEGIM KOMPETENCE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 9000, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; të pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Drejtësisë për datat 28.10.2024 dhe 29.10.2024, zëvendësministrit të Drejtësisë, z. Klajd Karameta.

2. Ngarkohet zëvendësministri i Drejtësisë, z. Klajd Karameta për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË**Ulsi Manja**

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2024

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 128 lekë

